



**10 SUGJERIME PËR TË
MBROJTUR PRIVATËSINË NË
INTERNET**



Mendoje mirë, përpara se të publikosh të dhënat e tua personale (sidomos emrin, adresën, numrin e telefonit) në një profil. Mendo se fotografitë dhe informacionet që do të vendosësh në Internet mund të rishfaqen pas shumë vitesh.



Ki kujdes kur jep informacione mbi shëndetin apo aspekte të jetës intime me miqtë virtualë sepse mund të kenë “efekte anësore” në jetën reale.



Asnjëherë mos u ndje shumë i sigurt. Fotografitë dhe videot që shkëmbehen në mënyrë private me miqtë, mund të kopjohen ose të shpërndahen dhe tek të tjerët.



**KEEP
CALM
AND
Don't
TAG ME**

Respekto të tjerët!

Mos publiko informacione personale apo fotografi (as ti bësh tag) pa marrë lejen e tyre.



**Vëri kyçin kompjuterit,
celularit apo tabletit.
Vendos fjalëkalime të
ndërlikuara për llogaritë
personale në Internet dhe
për pajisjet elektronike.**

**Nëse është e mundur krijo
pseudonime të ndryshme
në rrjete sociale të
ndryshme. Mos vendos
asnjëherë datëlindjen dhe
informacione personale në
pseudonimin tënd.**



Mos e përdor anonimitetin për të ofenduar. Nëse është e mundur për të mbrojtur privatësinë tënde përdor pseudonime por mos e përdor atë për të ofenduar të tjerët.



Kërko që të dihet vendndodhja jote vetëm nga miqtë dhe familjarët. Çaktivizo funksionet e gjeolokalizimit në mënyrë që të mos gjurmohesh nga të panjohur.



Bëj kujdes në informacionet që jep në një rrjet social apo aplikacion në telefonin celular. Kontrolllo politikën e privatësisë së rrjetit social apo aplikacionit dhe përcakto rrethin më të ngushtë të miqve të cilët mund të kenë akses në informacionet e tua.



www.idp.al

**Për më shumë informacion dhe këshilla rreth mbrojtjes së
privatësisë mund të gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit për të
Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

www.idp.al



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**